



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**



**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

**Komuna e Podujevës**

**Nr. 8**

**Podujevë, datë 04.09.2024**

## **PROCESVERBAL**

Nga dëgjimi i Tetë buxhetor për buxhetin e vitit 2025 të Komunës së Podujevës.

Mbajtur me datë 4 shtator 2024 nga ora 18:00.

### **Të dhënat e përgjithshme**

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Podujevës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 15/09/2024 në emalin fatlum.osmani@rks-gov.net ; liridona.rrahmani@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimit në Komunën e Podujevës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmbanë të dhëna për fazën përgaditore të dëgjimit përmbledhjen na takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit

### **Veprimet para nisjes së takimit:**

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve. Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre.

Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i draft buxhetit i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpret për personat me aftësi të kufizuar.

### **Zhvillimet gjatë takimit:**

Takimi ka nisur në ora 18:15 të pranishëm ishin drejtori i Drejtorisë për Arsim, Avni Fetahu, drejtoresha e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Lirie Hoti dhe anëtarja e grupit punues Liridona Rrahmani. Nga qytetarët morën pjesë 5 qytetarë prej të cilëve të gjithë të gjinisë mashkullore.

(Shih aneks Fotografi nga takimi, shih në aneks listën e pjesmarrësve)

**Takimi u hap nga moderatorja.** “ Të nderuar qytetarë të Podujevës sot jemi mbledhur në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal për vitin 2025.

*Ky proces zhvillohet nën patronatin e kryetarit të Komunës, z. Shpejtim Bulliqi dhe ekipit që organizon këto takime i cili është i mandatuar nga kryetar.*

*Ky takim dhe takimet tjera zhvillohen në kuadër të obligimeve ligjore të ligjit për vetëqeverisjen lokale ligjin për financat dhe rregullores për transparencën komunale.*

*Takimi që po e mbajmë sot është pjesë e planit të komunës për dëgjimet buxhetore dhe këtij takimi i ka paraprirë dëgjimi për KAB dhe miratimi i qarkores së parë buxhetore. Para se të fillojmë takimin unë iu shpërndava në ulëset e juaja agjendat e këtij takimi dhe materialet dhe ne synojmë që sot të dëgjojmë kërkesat nga ana juaj.*

*Këto kërkesa do të regjistrohen në procesverbal, ndërsa komuna saktësisht grupi punues do të trajtoj secilës kërkesë veç e veç.*

*Ju njoftoj se në fund të ciklit të dëgjimeve ne do të hartojmë raportin nga dëgjimet dhe grupi punues do të jap përgjigje dhe arsytetime konkrete për secilën kërkesë tuajën.*

*Të gjithë ju që jeni prezent sot këtu në muajin shtator mund të lexoni raportin dhe të merrni informacione nëse kërkesa juaj është në buxhet ose jo, për më tepër nëse nuk është adresuar mund të kërkonit sërish adresimin e saj në dëgjimin buxhetor që mban Kuvendi i Komunës.*

*Një informacion tjetër para se të vazhdojmë me agjendën, ju përveç adresimit fizik kërkesat mund t'i dërgoni edhe të shkruara në email-at që i keni të shkruara në agjendë para jush.*

*Të pranishmit u njoftuan nga moderatori se për qëllime të dokumentimit të këtij takimi do hartohet procesverbali dhe komuna do publikoj video dhe fotografi nga ky takim.*

*Të gjithë të pranishmit dhanë pajtimin për regjistrimin e takimit dhe publikimin e imazheve nga ky takim.*

### **Pas përfundimit të fjalimit të moderatores fjala ju dha drejtorit të Arsimit.**

*Drejtori i drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu tha se në bazë të qarkoren buxhetore projekt-buxheti për vitin 2025 është 33,459,115.00 euro, ndërsa shuma nga granti i Qeverisë 31,472,779.00 i ndarë për administratën komunale 14,784,618.00 euro, për shëndetësinë primare 3,347,173.00 euro, për arsimin fillor dhe të mesëm 13,190,988.00 euro dhe për shërbimet rezidenciale 150,000.00 euro.*

*Sa i përket të hyrave vetanake kemi gjithsej 1,986,336.00 euro, ku specifikisht për të hyrat vetanake komunale 1,756,336.00 euro, të hyrat nga shëndetësia 80,000.00 euro dhe të hyrat nga arsimi 150,000.00 euro.*

*Ndërsa limtet buxhetore për shpenzimet në sektore janë:*

*Nga administrata komunale për paga do të jenë: 2,612,603.00 euro, për mallra dhe shërbime 1,883,000.00 euro, për shpenzime komunale 393,000.00 euro, subvencione dhe transfere 1,370,000.00 euro, për shpenzime kapitale 6,846,442.00 euro, e që në total janë 13,105,045.00 euro.*

*Nga sektori i Shëndetësisë do të kemi 2,380,508.00 euro për paga, 990,033.00 euro për mallra dhe shërbime, 105,600.00 për shpenzime komunale, 320,000.00 euro për subvencione dhe transfere, 160,000.00 për shpenzime kapitale dhe në total janë 3,956,141.00 euro.*

*Në sektorin e Arsimit kemi 12,571,282.00 euro për paga, 1,171,999.00 euro për mallra dhe shërbime, 130,000.00 euro për shpenzime komunale, 120,000.00 euro për subvencione dhe transfere dhe 1,970,000.00 euro për shpenzime komunale e në total janë 15,963,281.00 euro*

*Nga shërbimet rezidenciale kemi 104,646.00 euro për paga, 45,000.00 euro për mallra dhe shërbime, 5,000.00 euro për shpenzime komunale, 280,000.00 euro për shpenzime kapitale ndërsa totali është 434,648.00 euro.*

*Ndërsa nga shpenzimet totale për të gjitha sektoret për paga kemi 17,669.041.00 euro, për mallra dhe shërbime 4,090.032.00 euro, për shpenzime komunale 633.600.00 euro, për subvencione dhe transfere 1,810,000.00 euro, për shpenzime kapitale 9,256,442.00 euro dhe totali i të gjitha 33,459,115.00 euro.*

Pasi drejtori përfundoi prezantimin, ia kaloi fjalën drejtoreshës së Bujqësisë, Lirie Hoti, e cila prezantoi gjithashtu projektet e drejtorisë së Bujqësisë.

Pasi përfundoi prezantimin drejtoresha e Bujqësisë, Lirie Hoti, fjala iu dha qytetarëve pjesëmarrës për të parashtruar kërkesat dhe sugjerimet e tyre lidhur me projekt-buxhetin.

### **Kërkesat e qytetarëve në dëgjim:**

Naim Bajrami

- 1) Kërkesë për rrethojat e shkollës në fshatin Orllan
- 2) Subvencionimi i një serre për nxënësit e shkollës, për të kultivuar dredhëz

Blerim Latifi

- 1) Rregullimi i sallës së edukatës fizike
- 2) Rregullimi i infrastrukturës së shkollës në Shtedim

Shaip Aliu

- 1) Ndërtimi i një objekti të ri për klinikë
- 2) Kërkesë për mësim tërëditor në shkollat e Podujevës

Muhamet Jashari

- 1) Kërkesë për ndërtimin e një fushe të edukatës fizike te shkolla “Ibrahim Rugova”, ku mund të kenë casje edhe banorët.

## Përfundimi

Në fund të takimit palët janë njoftuar se dëgjimet buxhetore do vazhdojnë sipas kalendarit të paraparë dhe po ashtu janë njoftuar se komentet mund ti dërgojnë të shkruara në e-mailat e komunës [liridona.rrahmani@rks-gov.net](mailto:liridona.rrahmani@rks-gov.net) dhe [fatlum.osmani@rks-gov.net](mailto:fatlum.osmani@rks-gov.net).

Takimi u mbyll në ora 19:05.

Në këtë takim kontribuan me pjesëmarrje 5 persona, më gjithësej 7 kërkesa të regjistruara.

*Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.*

Gra	0
Burra	5
Totali	5

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani






Foto 1. Fotografi gjatë mbajtjes së takimit





Foto 2. Fotografi gjatë mbajtjes së takimit



Foto 3. Fotografi gjatë mbajtjes së takimit



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik buxhetor me sektorin e Shërbimeve Publike, sektorin e Arsimit dhe të Shëndetësisë.

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	Dardhan Ahmet	Podujevë		
2	MUHAMMEDI JASHARI	PODUEVË		
3	Pleum Latifi	Podujevë		
4	Adil Halili	Metohi		
5	Wahid Bajrami	Qelëan		
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				

---

28				
29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

**Vërejtje:**

*Me nënshkrimin tim në listën e komunës unë konfirmoj se komuna mund të përdorë kontaktet e ofruara nga ana ime për të më dërguar njoftime periodike për ngjarje të cilat janë në interes publik.*

*Me nënshkrimin tim konfirmoj se autoritetet e komunës mund të regjistrojnë takimin për qëllime të procesverbalit dhe të publikimit të fotografive dhe video materialeve provuese nga këto takime.*

Podujevë

04.09.2024